



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2016

ZGJIDHJE E TESTIT

Lënda: Teknologji e thelluar

Varianti A

1. Energjia e biomasës është: 1 pikë  
A) e ripërtërishme  
B) e pashtershme  
C) e paripërtërishme  
D) e fundme
2. Cili është elementi kryesor në lidhjen e gizës? 1 pikë  
A) karboni  
B) hekuri  
C) mangani  
D) kobalti.
3. Plani urbanistik pjesor është: 1 pikë  
A) **Paraqitja në vizatim e një zone të caktuar të qytetit e parë nga sipër duke treguar gjithcka;**  
B) Paraqitje aksonometrike e një objekti ndërtimi;  
C) Paraqitja në letër e një prerjeje horizontale të ndërtesës në lartësinë e dymëve dhe të dritareve.  
D) Planimetria e një zone të caktuar.
4. Hapja e sipërfaqes anësore të një cilindri, është: 1 pikë  
A) **Një drejtkëndësh me përmasa:  $(h \times 2\pi r)$**   
B) Një drejtkëndësh me përmasa:  $(h \times d)$   
C) Një katror me brinjë  $d$  (sa diametri i rrethit të bazës)  
D) Një rreth me diametër  $d$ .
5. Kalitja e materialeve është: 1 pikë  
A) Vetë fizike  
B) Vetë mekanike  
C) **Vetë teknologjike**  
D) Vetë kimike
6. Kur koni i drejtë pritët me një rrafsh të pjerrët figura e ndërprerjes është: 1 pikë  
A) Drejtkëndësh  
B) Rreth  
C) Trekëndësh  
D) **Elips**

7. Vizatimet konstruktive bëjnë pjesë në: 1 pikë  
 A) **Projektin e ndërtimit**  
 B) Planin e përgjithshëm;  
 C) Projektin arkitektonik;  
 D) Pamjet dhe prerjet e ndërtesës.
8. Me automatizim të proceseve kuptojmë përdorimin e mjeteve teknike që reduktojnë në maksimum: 1 pikë  
 A) konsumin e energjisë  
 B) ndërhyrjen e makinerive  
 C) nevojën e pajisjeve  
 D) **ndërhyrjen e njeriut.**
9. Sustat janë: 1 pikë  
 A) Detale unazore që vendosen midis detalit dhe dados dhe lehtësojnë shtrëngimin  
 B) **Detale elastike që vendosen midis dy detaleve të tjera, për ti shtyrë apo tërhequr ato**  
 C) Detale prej gome apo plastike që vendosen midis dy detaleve, që të puthiten mirë  
 D) Detale në formë shufre me kokë të profiluar.
10. Sterilizimi është një process termik që zhvillohet në temperaturën : 1 pikë  
 A) **115-125 gradë celsius**  
 B) 63-83 gradë celsius  
 C) 90-100 gradë celsius  
 D) 10 gradë celsius
11. Ndotja e mjedisit përbën një problem të madh për shoqërinë dhe kryesisht ndotja e ajrit e krijuar nga shtimi i mjeteve të transportit.  
 Planifikoni hapat e nevojshme për zgjidhjen e këtij problemi 5 pikë

**Përgjigje:**

**1-Përcaktimi i problemit:** “Ndotja e ajrit nga mjetet e transportit”

**2- Alternativat e zgjidhjes;**

- a) Kontrolli teknik i mjeteve dhe nxjerrja nga qarkullimi i atyre me probleme serioze, më të vjetrat, që krijojnë shumë ndotje;  
 b) Mbjellja e fidanëve në akset kryesore të rrugëve, atje ku ka më shumë trafik;  
 c) Rregullimi i trafikut të transportit, duke bërë të mundur qarkullimin e reduktuar të mjeteve ( një ditë gjysma e tyre me nr.tek të targave dhe ditën tjetër, nr.cift i tyre)

**3- Zgjedhja e alternativës më të mirë:** një nga zgjidhjet më të mira është mbjellja e fidanëve në akset kryesore të rrugëve, atje ku ka më shumë trafik; sepse ul ndotjen dhe zburon edhe qytetin( mund të pranohet edhe zgjidhje tjetër e nxënësit kur ajo është optimale dhe realizon në mënyrë të saktë dhe të argumentuar zgjidhjen e këtij problemi teknologjik)

**4- Zgjidhja e problemit në praktikë;**

a) Inputet:

- Njerëzit :specialistët e duhur, punëtorët dhe personat përgjegjës;
  - Mjetet materiale : mjete pune(lopata, kazma), fidanët, plehu (organik+kimik), ujë, etj
  - Mjetet financiare:paratë e nevojshme në system për të blerë fidanët, pagat e punëtorëve, plehun, etj.
  - Energjia: energjia biologjike e njerëzve, energjia termike e mjeteve të transportit dhe ajo ekologjike diellore, që ndikon në rritjen dhe zhvillimin e fidanëve.
  - Kohëzgjatja e sistemit: Koha e nevojshme deri në përfundimin e mbjelljes së të gjithë fidanëve.
- b) Proceset : të gjitha proceset që kryhen për mbjelljen e fidanëve(mbjellje,plehërim,ujitje etj);

**5- Konkluzionet e zgjidhjes dhe përmisimi:**

Mbjellja me sukses e të gjithë fidanëve të parashikuar;

Si u realizua zgjidhja, si shkoi zhvillimi i sistemit, etj

12. Në ditët e sotme panelet fotovoltaike kanë marrë një zhvillim të madh.

- a) Tregoni ndryshimin ndërmjet tij dhe panelit diellor  
b) Çfarë përmisimi mund ti bëhet paneleve fotovoltaike

2 pikë

1 pikë

**Përgjigje:**

- a) Panelet diellore ngrohin ujin, kurse ato fotovoltaike shërbejnë për të prodhuar energji.  
b) Në energji elektrike kthehet vetëm 10-12% e sasisë të energjisë diellore, për këtë duhet punuar që të rritet rendimenti, si edhe të ulët kostoja e tyre.

13. Qeramikat përbëjnë një grup kryesor të materialeve teknologjike.

Tregoni dy nga përdorimet kryesore të të qeramikës sipas vetive të tyre.

2 pikë

**Përgjigje:**

Grupi i qeramikës përdoret: për enë kuzhine, për pllaka shtrimi-dyshemeje, pajisjet hidrosanitare, për materiale ndërtimi, materiale abrazive, pllaka zjarrduruese, xhamat, enë qelqi, pajisje optike, etj.  
Vetitë që e bëjnë të përdoret janë: rezistenca në temperature të larta, janë dielektrikë, nuk mbajnë ngarkesa të mikroorganizmave, higjena që sigurojnë etj

14. Në një transmesion me rula me fërkim largësia ndërmjet 2 boshteve paralele është 300 mm. Vizatoni skemën e këtij transmesioni dhe përcaktoni diametrat e këtyre ruleve për raportin e transmesioneve  $i=0.5$ .


3 pikë

U 14

Të dhëna:

$l = 300 \text{ mm}$   
 $i = 0,5$

$D_2 = ?$ ,  $D_m = ?$



Në transmesionet me rula me fërkim raporti llogaritet

$$i = \frac{D_2}{D_m}$$

është dhënë distanca  $l$  që është sa shuma e 2 rrezëve të ruleve pra

$$l = \frac{D_2 + D_m}{2} \quad \text{pra} \quad D_2 + D_m = 300 \times 2$$

Nga kjo nxjerrim  $D_2 = 600 - D_m$

Bëjmë zëvendësimet në formulë

$$0,5 = \frac{600 - D_m}{D_m}$$

$D_m = 400 \text{ mm}$        $D_2 = 600 - 400 = 200 \text{ mm}$

15. Sistemi i frenimit ndodhet tek të gjithë mjetet e transportit  
Përcaktoni detyrat që realizon ky sistem në automjet.

1 pikë

**Përgjigje:**

Sistemi i frenimit është tërësia e pajisjeve që shërbejnë për të ulur shpejtësinë e automjetit gjatë lëvizjes, për ta ndaluar atë ose për ta mbajtur të palëvizshëm në rrugët me pjerrësi.

16. Në ndërtim përdoren disa lloje sistemesh konstruktive. Një prej tyre është ai me kapriata

- a) Skiconi këtë sistem konstruktiv  
b) Tregoni përdorimin në praktikë të këtij sistemi  
c) Tregoni materialet teknologjike prej të cilëve ndërtohen këto struktura


1 pikë

1 pikë

1 pikë

**Përgjigje**

- a) vizatimi i strukturës



- b) përdoren te kapanonet e mëdhenj, tek çatitë, stallat etj  
c) çeliku, beton i armuar, druri

17. Mbrojtja e bimëve ka rëndësi në teknologjinë bujqësore.

- a) Kush janë dëmtuesit kryesorë të kulturave bujqësore.  
b) Si realizohet procesi teknologjik i mbrojtjes të integruar të bimëve

1 pikë


2 pikë

**Përgjigje:**

- a) Dëmtuesit kryesorë të kulturave janë brejtësit, barërat e këqija, insektet etj  
b) Proçesi i integruar realizohet me anë të kombinimit të metodave psh: luftës biologjike me atë kimike për të arritur rezultate më të mira pa dëmtuar tokën dhe kulturat bujqësore

18. Të vizatohet projektioni izometrik i piramidës së drejtë me bazë katrore me brinjë  $a = 3\text{cm}$ ; dhe lartësi  $h = 6\text{cm}$ . Ndërtimi, të shoqërohet me 2 pamjet në ortogonal. **3 pikë**


## Zgjidhja




- a) Izometria  
b) Pamjet në projektionet ortogonal (këndrejtë)

19. Jepet trupi si në figurën e mëposhtme:

- a) Ndërto pamjen në horizontal. **1 pikë**  
b) Ndërto pamjen në vertikal.. **1 pikë**  
c) Realizo prerjen me rrafshin prerës (si në figurë), duke ndjekur rregullat për vijëzimet dhe emërtimin e prerjes. **2 pikë**



Zgjidhja



20 Ne figurë ju është dhënë një kon i prerë pjerrtaz .

a) Plotësoni pamjen në anësor duke përcaktuar edhe pikat e prerjes.

1 pikë

b) Realizoni hapjen e pjesës së prerë.

2 pikë

Zgjidhje

